



VENDIM

Nr. 27 Date 11.07.2014

PER DHENIEN E TITULLIT “NDERI I QARKUT KUKES” PROGRAMIT SHQIPTAR TE ÇMINIMIT “ALBANIAN MINE ACTION EXECUTIVE (AMAE)”

Këshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij te datës se mesiperme, pas propozimit të bërë nga një grup këshilltaresh, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/VII/a, 54, ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin Nr.112/2013 te miratuar me date 04.04.2013 “Per dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore te nderit ne Republiken e Shqiperise”, nenet 14, 15 dhe 16, si dhe vendimin e Këshillit të Qarkut Kukës Nr.9 date 12.02.2013 “Për miratimin e rregullores së proçedures së dhënies së “Titujve të Nderit”,

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit “Nderi i Qarkut Kukës”, Programit Shqiptar të Çminimit - “Albanian Mine Action Executive (AMAE)”, me motivacionin:

“Për kontributin e veçantë dhënë në Qarkun e Kukësit, lidhur me operacionet e çminimit, edukimin e popullsisë ndaj rrezikut të minave dhe asistencen ndaj të aksidentuarve”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KRYETARI

Ibsen ELEZI

Konc: E.Cahani

Ligjshmeria: G.Cejku

Sekretari: B.Ngjeci

U hartua ne 3 (tre) kopje origjinale:

1.Zyres se Protokoll Arkivit

